Sinjalizime

# Të shtëna në aheng familjar në Podujevë – 27-vjeçari pranon para Policisë se shtiu, gjenden gëzhojat




Sinjali.com 10 Gusht 2026 09:28

**Një tjetër rast i të shtënave gjatë një ahengu familjar është regjistruar mbrëmjen e së dielës në fshatin Bellopojë të Podujevës, ku Policia ka intervenuar pas raportimeve për të shtëna.**

Sinjali mëson se i dyshuari është Blerond Abazi rreth 27-vjeç, i cili ka pranuar para zyrtarëve policorë se kishte shtënë me armë me gaz gjatë ahengut.

Rasti është raportuar më 9 gusht, rreth orës 22:00, ndërsa njësitë policore kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe, pas konsultimit me Prokurorin kujdestar, kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, Abazi u ka deklaruar policëve se kishte shtënë me armë me gaz gjatë një ahengu familjar.

Në vendin e ngjarjes janë gjetur katër gëzhoja, të cilat janë evidentuar në kuadër të rastit.



Lexo edhe
Ahengu familjar në Podujevë shoqërohet me të shtëna – 32-vjeçari pranon para Policisë se shtiu, gjenden 12 gëzhoja

Blerond Abazi është intervistuar në cilësinë e të dyshuarit, ndërsa pas përfundimit të procedurave është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti është iniciuar për veprat *"Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës"* dhe *"Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm"*.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

**/GazetaSinjali/**

Policia Podujevë gjuajtje Armë

## Të tjera:




**Policia e Kosovës pajiset me 15 vetura të reja hibride për policët e lagjes**
Kosovë



**KFOR nis ndryshimin e sigurisë në Manastirin e Deçanit, përfshihet gradualisht Policia e...**
Kosovë



**Ekskluzive| Plumbi "qorr" çan çatinë dhe përfundon brenda dhomës së një shtëpie...**
Sinjalizime



**Ekskluzive | Breshëri plumbash në një ndërtesë në Mitrovicë – qëllohet nga dy anët, d...**
Sinjalizime



**Ahengu familjar në Podujevë shoqërohet me të shtëna – 51-vjeçari pranon se shtiu disa...**
Sinjalizime



**Ekskluzive | Kanosje ndaj ish-gruas te "Dukagjini Residence" – Policia kap të dyshuari...**
Sinjalizime



**Ekskluzive| Rrahje për fëmijët në Han të Elezit: Tre burra sulmojnë 55-vjeçarin – njëri ikën ed...**
Sinjalizime



**Ekskluzive | Rrahje në trafik në Llapushnik – sulmohet një zyrtar policor jashtë detyre d...**
Sinjalizime



All rights are reserved 2025, Copyright Sinjali.com